

Të mësuarit me kompetenca në arsimin fillor

Çështjet:

Veçoritë e arsimit fillor (klasa I – V)

Kompetencat kyçe

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe për shkallë

Veçoritë e arsimit fillor (klasa I – V)

Në arsimin fillor, përvojat mësimore i shërbejnë përshtatjes së fëmijëve me një formë më të sistemuar të të nxënit nëpërmjet lojës, punës, mësimi, si dhe aftësimit të tyre për të bërë dallimin mes lojës dhe detyrës. Realizimi i procesit mësimor bëhet në mënyrë të integruar, në mënyrë që marrëdhënia e fëmijëve me mjedisin natyror dhe me mjedisin e krijuar nga njeriu, të kuptohet në mënyrë sa më të plotë. Gjatë arsimit fillor, procesi i të nxënit përqendrohet në përvetësimin e bazave të lexim-shkrimit dhe në hedhjen e bazave të shëndosha për zhvillimin njohës, socio-emocional dhe motorik. Kujdes i veçantë i kushtohet zhvillimit të personalitetit të fëmijës dhe qëndrimit pozitiv ndaj të nxënit, si bazë për zhvillimin e kompetencës kyçe “Të mësuarit për të nxënë”. Proces i mësimor në arsimin fillor organizohet, ofrohet, lehtësohet dhe bashkërendohet nga mësuesi i klasës, i ndihmuar, sipas nevojës, nga asistenti dhe mësuesi i specializuar i lëndës.

Kompetencat kyçe

Kompetencat shprehen nëpërmjet përdorimit të njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve në trajtimin e plotë dhe të kuptueshëm të situatave të kontekstit. Zhvillimet e sipërpërmendura dhe nevojat për ndryshime arsimore, e bëjnë të qartë domosdoshmërinë për të nxënë gjatë gjithë jetës. Qytetarëve të shoqërisë së dijes u nevojitet të zhvillojnë njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet vetjake, shoqërore dhe ato që lidhen me botën e punës dhe tregun e lirë. Proces i arsimit do t'i mundësojë çdo nxënës zotërimin e kompetencave kyçe, të nevojshme për jetëndhe punën. Rrugët dhe mënyrat, me të cilat njerëzit i qasen sot informacionit dhe shërbimeve, ndryshojnë vazhdimisht. Për këtë arsye, të gjitha moshat kanë nevojë të pajisen me kompetenca të reja, që i ndihmojnë të përshtaten në botën e

sotme digjitale, jo vetëm nëpërmjet fitimit të njohurive dhe aftësive teknike, por edhe nëpërmjet të kuptuarit të thellë të mundësive, sfidave dhe çështjeve etike, ligjore dhe shoqërore, që lindin ose shoqërojnë zhvillimet e reja ekonomike, shoqërore dhe teknologjike. Këto ndryshime shtrojnë domosdoshmërinë e zotërimit të kompetencave, që i aftësojnë individët të menaxhojnë ndryshimet dhe situatat e reja. Në përputhje me qëllimet e arsimit parauniversitar, këto kompetenca janë:

- Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.
- Kompetenca e të menduarit.
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.
- Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin.
- Kompetenca personale.
- Kompetenca qytetare.
- Kompetenca digjitale.

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, kompetenca e të menduarit dhe kompetenca për të mësuar kanë natyrë instrumentale. Ato janë bazë për kompetencat tjera, që janë më tepër të lidhura me rrethanat dhe me përmbajtjen e caktuar, siç janë kompetencat e nevojshme në jetën personale, publike dhe profesionale.

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive) Me qëllim që fëmijët dhe të rinjtë të zhvillojnë personalitetin, të nxënë dhe të marrin pjesë aktive në shoqëri, është me rëndësi që t'i kuptojnë mesazhet që u drejtohen dhe të shprehen në mënyrë të përshtatshme me anë të gjuhëve, simboleve, shenjave, kodeve dhe formave artistike. Për t'u bërë komunikues efektivë, nxënësit ndihmohen që të shfrytëzojnë në mënyrë të pavarur, kritike dhe krijuese mjetet dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe për shkallë

Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe për shkallë shprehin kërkesat themelore për zhvillimin e kompetencave kyçe në përfundim të një shkalle të caktuar të kurrikulës si dhe kushtin për kalim nga një shkallë në tjetrën. Rezultatet e të nxënit për shkallë nxitin integrimin e mëtejshëm të fushave të të nxënit, në funksion të zhvillimit të kompetencave kyçe. Ato parashikohen që të përvetësohen nga të gjithë nxënësit.

Në Shqipëri:

Tabela e rezultateve të të nxëniet të kompetencave kyçe për shkallën 1

Nr.	Shkalla 1 Klasa përgatitore, klasa I, II	Nivelet e kompetencës			
		1	2	3	4
I.	Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit <i>Nxënësi komunikon në mënyrë efektive</i>				
	1. Ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar, përmbajtja e të cilit nuk është më shumë se				

	një faqe teksti e shtypur.				
	2. Shpreh me gojë dhe me shkrim për 3-5 minuta para moshatarëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të një filmi, drame ose dokumentari, dëgjimit të një tregimi apo përralle, shikimit të një vallëzimi; dëgjimit të një kënge apo melodie.				
	3. Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.				
	4. Përshkruan në forma të ndryshme shprehëse mjedisin natyror me të cilin				

	rrethohet apo ndonjë ngjarje shoqërore dhe e prezanton atë para të tjerëve.				
	5. Lexon me zë një tekst së paku prej gjysmë faqeje që ka të bëjë të pa lexuar me parë.				
	6. Shkruan një tekst të shkurtër (gjysmë faqe - rreth 250 fjalë) për një temë të caktuar.				
	7. Shpreh mesazhin e një teksti të thjeshtë letrar, përmes njëres nga format shprehëse si të folurit, shkrimit, vizatimit, dramatizimit (lojë me role), këngës apo vallëzimit.				
	8. Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi apo kënge dhe luan rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarët.				

Në Mal të Zi:

Klasa I-II

Nxënësit:

-dëgjojnë dhe flasin,fillojnë të hulumtojnë dhe njohin mundësitë e komunikimit të shkruar;

-dëgjojnë tekste të lexuara/të treguara

-zbulojnë funksionin dhe rëndësinë e komunikimit në shkollë dhe hulumtojnë raportet në mes shpalljeve/lajmërimeve gojore dhe atyre me shkrim.

-përvetësojnë elemente të caktuara të shkronjave,ushtrojnë motorikën e dorës

-mësojnë të përdorin pajisje të ndryshme për shkrim

-ushtrojnë mbajtjen e drejtë të trupit dhe dorës

-krahas lojës zhvillojnë shkathtësitë e nevojshme për shkrimin e shkronjave (vizatimi i harqeve,vijave të ndryshme të pjerrëta, lakore, vijave horizontale dhe vertikale)

-zhvillon aftësinë e të folurit,zhvillon të menduarit logjik dhe aftësinë për të nxjerrë përfundime;

-përvetëson dhe përdor shprehje të reja (e pasuron fondin e fjalëve)

-përmes lojës ushtrojnë parimin e alfabetit dhe zhvillojnë ndjeshmërinë e zërit(vërejnë rënditjen e tingujve/shkronjave në fjalë)

-mësojnë lexim-shkrimin fillestar, përdorin elementet e metodës globale.

Në shkallën e dytë kemi si më poshtë:

Në Shqipëri:

Tabela e rezultateve të të nxënësve të kompetencave kyçe për shkallën 2

Nr.	Shkalla 2 Klasa III, IV, V	Nivelet e kompetencës			
		1	2	3	4
I.	Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit <i>Nxënësi komunikon në mënyrë efektive</i>				
	1. Shpreh përjetimet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit dhe dëgjimit të një filmi, dokumentari, ekspozite, dramatizimi, recitimi, interpretimi muzikor ose leximit të një libri në njërin nga format shprehëse (me gojë, me shkrim, vizatim, mimikë, lëvizje etj).				
	2. Dëgjon me vëmendje prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim me pyetje, komente apo sqarime.				
	3. Merr pjesë në organizimin e një shfaqje artistike duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit.				
	4. Lexon saktë me zë një tekst letrar ose jo letrar të palexuar më parë.				
	5. Shkruan një tekst rreth një faqe (rreth 100 fjalë) për një temë të caktuar.				
	6. Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, kënge dhe i analizon duke bërë një listë tiparet e tyre, diskuton rreth tyre, luan rolin e njërit prej				

Në Mal të Zi:

Shkalla e dytë (Mali i Zi)

Klasa III-V

Nxënësit:

-shkruajnë diktime, kopjojnë nga tabela, nga libri;

-me hyrjen në botën e lexim/shkrimit kryejnë aktivitete të tjera: bisedojnë gjatë formave të ndryshme të mësimit bashkëpunojnë, përceptojnë (dëgjojnë, lexojnë, shikojnë, analizojnë dhe krijojnë tekste joartistike, përceptojnë, interpretojnë dhe krijojnë tekste artistike;

-zhvillojnë aftësitë e të menduarit logjik, të emërimit, të tregimit dhe aftësitë e shqiptimit të drejtë, zotërojnë njohuritë themelore të drejtshkrimit;

-sistematikisht njohin dhe i përvetësojnë parimet themelore të komunikimit dialogjik dhe i aplikojnë në bisedat e veta dhe lojën e roleve;

-zhvillojnë aftësitë e drejtimit të bisedimit të njerëzishëm dhe të durueshëm;

-formojnë parimin kritik të teksteve joartistike dhe kuptojnë se krijimi i tekstit (gojor ose i shkruar) është një aktivitet për të cilën duhet përgatitje.